



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 03/L-018**

**PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR DHE PROVIMIN E MATURËS SHETËRORE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Me qëllim të sigurimit të një kornize ligjore për rregullimin e Provimit Përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore në Kosovë,

Miraton

**LIGJ PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR DHE PROVIMIN E MATURËS  
SHETËRORE**

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Projektligj rregullohen mënyra e organizimit, përmbajtja, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit përfundimtar dhe provimit të Maturës shtetërore.

## **Neni 2 Përkufizimet**

**“Provimi përfundimtar”** është vlerësim i brendshëm i përfundimit të një niveli arsimor me të cilin verifikohet arritshmëria e njohurive dhe shkathtësive për përcaktimin e arritjeve përfundimtare në shkollat Profesionale.

**“Matura shtetërore”** është provim përfundimtar i standardizuar, monitoruar dhe vlerësuar, që vërteton mbarimin e shkollës së mesme të lartë dhe dëshmon shkallën e aftësisimit të kandidatit për punë dhe vazhdimin e studimeve në universitet, në përputhje me kriteret përkatëse të pranimit.

**“Kandidat”** është nxënësi, vijuesi dhe personi i cili e përfundon me sukses klasën përfundimtare të arsimit të mesëm të lartë 12 ose 13.

**“Administruesit dhe Vëzhguesit”** janë të gjithë personat të cilët caktohen nga organet kompetente për administrimin e testimit.

**“Test i standardizuar”** është testi i përpiluar dhe bazhdaruar në pajtim me karakteristikat metrike të testeve që janë sajuar nga një institucion i profesionalizuar për hartimin e testeve të tilla.

## **Neni 3 Mbajtja e provimit**

1. Provimi përfundimtar mbahet në pjesën teorike dhe praktike varësisht nga profilet e caktuara
2. Provimi i maturës mbahet me test të standardizuar.

## **Neni 4 Provimi përfundimtar dhe provimi i maturës shtetërore**

1. Provimi përfundimtar është vlerësim i brendshëm i përfundimit të një niveli arsimor me të cilin verifikohet arritshmëria e njohurive dhe shkathtësive për përcaktimin e arritjeve përfundimtare në shkollat Profesionale.
2. Provimi i maturës shtetërore është proces i mbledhjes, përpunimit, analizimit, vlerësimit dhe i interpretimit të të dhënave me qëllim të përcaktimit të shkallës së zotërimit të objektivave të përcaktuara në programet shkollore.

## **Neni 5 Kandidatët**

1. Provimit përfundimtar kandidatët i nënshtrohen në kushte dhe kritere të njëjta në pjesën teorike dhe praktike sipas profilit të caktuar arsimor.
2. Provimit të maturës kandidatët i nënshtrohen në kushte dhe kritere të njëjta dhe në të njëjtën kohë.
3. Kandidatët me nevoja të veçanta i nënshtrohen provimit përfundimtar dhe të maturës sipas kushteve dhe kritereve të përshtatura nevojave të tyre.
4. Provimit përfundimtar dhe të maturës i nënshtrohen edhe kandidatët nga arsimi i të rriturve.
5. Kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve me nevoja të veçanta dhe kandidatët të arsimit për të rritur do të përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

## **Neni 6 Kandidatët e kthyer nga jashtë**

1. Kandidati i cili jashtë Kosovës ka marrë një dëftesë të barasvlershme me dëftesën e mbarimit të shkollës së mesme të lartë në Kosovë, e cila është e nostrifikuar, ka të drejtë të hyj në provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore.
2. Kandidati i kthyer i nënshtrohet provimit aty ku e cakton MASHT-i, bazuar në dokumentin e nostrifikuar për drejtimin përkatës në bashkëpunim me DKA.
3. Kandidati i kthyer duhet t'i plotësojë kushtet e hyrjes në provim si të gjithë kandidatët e tjerë.

## **KREU II**

### **DISPOZITAT E VEÇANTA**

## **Neni 7 Kompetencat**

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për organizimin e provimeve përfundimtar dhe të maturës në bashkëpunim me:

- 1.1. Komisionin Qendror Shtetëror të Maturës(KQSHM);

- 1.2. Qendrën e Vlerësimit (QV);
- 1.3. Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA);
- 1.4. Komisionet e Qendrave të Testimit;
- 1.5. Komisionet e vlerësimit në shkolla; dhe
- 1.6. Këshillin e provimeve të shkollës.

## **Neni 8**

### **Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës**

1. Ministri emëron Komisionin Qendror Shtetëror të Maturës .
2. Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës (KQSHM) është organ mbikëqyrës, këshillues dhe vendimmarrës për të gjitha çështjet lidhur me maturën.
3. Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës ka nëntë (9) anëtarë të emëruar me mandat trevjeçar në këtë përbërje:
  - 3.1. MASHT-i dy (2) anëtarë,
  - 3.2. Universiteti tre (3) anëtarë,
  - 3.3. Akademia e Shkencave një (1) anëtar.
  - 3.4. Qendra e Vlerësimit një (1) anëtar.
  - 3.5. DKA një (1) anëtar
  - 3.6. Përfaqësues nga drejtorët e shkollave të mesme të larta një (1) anëtar.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës:
  - 4.1. miraton listën e anëtarëve të komisioneve të lëndëve për përpilimin e kërkesave për provimin shtetëror të maturës me propozimin e qendrës së vlerësimit;
  - 4.2. obligon DKA-në për grumbullimin e të dhënave për kandidatët e provimit të maturës sipas udhëzimeve të qendrës së vlerësimeve;
  - 4.3. bën planifikimin dhe përgatitjet për organizimin e provimit të maturës për vitin e ardhshëm në bashkëpunim me qendrën e vlerësimit më së largu deri më 31 dhjetor;

4.4. merr opinionet nga komuniteti për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit dhe mbi këto opinione nxjerr udhëzime dhe cakton përgjegjësitë për subjektet në procesin e provimit të maturës;

4.5. miraton katalogun e lëndëve si dhe bënë harmonizimin e lëndëve për provimin e maturës, në përputhje me plan programet mësimore sipas drejtimeve respektivisht profileve;

4.6. gjatë kohës së administrimit të testit në qendrat e testimit angazhon ekipet e shërbimit shëndetësor si dhe cakton mënyrën për ruajtjen e sekretit në provimin e maturës dhe në provimin përfundimtar;

4.7. publikon rezultatet e testit në marrëveshje me MASHT-in.

## **Neni 9** **Qendra e Vlerësimit (QV)**

1. Qendra e Vlerësimit vepron në kuadër të MASHT-it .

2. Puna e Qendrës për Vlerësimin e Provimit të Maturës është profesionale dhe me përgjegjësi.

3. Obligimet dhe përgjegjësitë e Qendrës së Vlerësimeve:

3.1. analizon plan programet dhe tekstet shkollore të miratuara nga MASHT, përgatit dhe publikon materiale ndihmëse për provimet e maturës;

3.2. harton teste të standardizuara në mbështetje të plan programeve dhe teksteve shkollore të miratuara nga MASHT;

3.3. propozon dhe trajnon anëtarët e Komisioneve si dhe individë të tjerë të përfshirë në zhvillimin e provimeve të maturës;

3.4. bën përgatitjen teknike shumëfishimin, paketimin, shpërndarjen dhe grumbullimin e materialeve për provimin e maturës shtetërore nën përcjelljen dhe sigurinë policore;

3.5. mbikëqyr tërë procesin e zhvillimit të provimit të maturës, organizon dhe realizon vlerësimin e teksteve, bën kontrollimin dhe përpilimin e të dhënave të kandidatëve;

3.6. shpall rezultatet e arritjeve të çdo kandidati në provimet e maturës dhe arkivon çdo material të provimit sipas ligjit të arkivimit dhe i ruan ato për 6 muaj në mjediset e institucionit;

3.7. përgatit Raportin për ecurinë e testit të maturës dhe raportin teknik mbi arritjet e kandidatëve në provimet e maturës dhe për këtë e informon MASHT-in;

3.8. krijon dhe procedon mënyrën e informimit rreth shpalljes dhe dokumenteve tjera për provimin e maturës në faqen elektronike dhe në media;

3.9. kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga organet mbikëqyrëse.

## **Neni 10** **Drejtoritë Komunale të Arsimit**

1. Detyrat dhe obligimet e DKA-së janë :

1.1. shpallja e njoftimit për vendimin e ministrit në lidhje me organizimin e provimit të maturës;

1.2. caktimi i detyrave dhe obligimeve për drejtorët e shkollave në lidhje me mbajtjen e provimi përfundimtar dhe të maturës sipas udhëzimeve të KQSHM;

1.3. siguron të dhënat e sakta dhe me kohë për kandidatët që do të vlerësohen përfshirë edhe kandidatët me nevoja të veçanta;

1.4. propozon administruesit dhe vëzhguesit sipas udhëzimeve të Qendrës së Vlerësimit;

1.5. pas vendimit të KQSHM cakton objektet për qendra të vlerësimit, koordinon punët shkollë- Qendër e Vlerësimit – Komision Qendror;

1.6. sjell raportin për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit brenda shtatë (7) ditëve në Qendrën e Vlerësimeve;

2. Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga organet mbikëqyrëse.

3. Mospërfillja e udhëzimeve nga Qendra e Vlerësimit do të sanksionohet.

## **Neni 11** **Komisioni në Qendrat e Testimit**

1. Komisioni në Qendrat e Testimit përbëhet nga tre (3) anëtarë:

1.1. nga dy (2) përfaqësues të MASHT-it, nga te cilët njëri është Kryetar dhe tjetri anëtar; dhe

1.2. DKA -ja një (1) anëtar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Qendrës së Testimit janë:

- 2.1. pranon testet nga Qendra e Vlerësimit, kontakton dhe koordinon punët me administruesit dhe vëzhguesit në Qendrat e Testimit;
  - 2.2. monitoron tërë procesin e testimit sipas udhëzimeve të KQSHM dhe pas përfundimit të testit pranon testet nga administruesit dhe vëzhguesit;
  - 2.3. ruan sekretin e testit prej pranimit të testit nga Qendra e Vlerësimit deri në dorëzimin e tyre në Qendrën e Vlerësimit;
  - 2.4. raporton te KQSHM për ecurinë e zhvillimit të testit në Qendrën e Testimit.
3. Për moszbatimin e detyrave të marra nga organet më të larta Komisioni ka përgjegjësi .

## **Neni 12**

### **Administruesit dhe Vëzhguesit e testeve**

1. Administruesit dhe vëzhguesit caktohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit për Drejtorinë Komunale të Arsimit të Komunës tjetër, ndërsa caktimi i tyre në paralele bëhet nga kryetarët e Komisioneve në Qendra të Testimit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit dhe të vëzhguesit të testit janë:
  - 2.1. verifikimi i kandidatëve të cilët hyjnë në provim të maturës;
  - 2.2. shpërndarja e testit personalisht secilit kandidat;
  - 2.3. marrjen e testit të plotësuar nga secili kandidat;
  - 2.4. mbajtja e rregullit dhe qetësisë në hapësirat ku mbahet provimi dhe krijimi i kushteve të sigurisë për ruajtjen e testeve të kandidatit deri në momentin e dorëzimit të tyre në Komisionin e Qendrës së Testimit.
3. Testet duhet të hapen dhe mbyllen në prani të kandidatëve nga pakot e veçanta me barkode.
4. Materiali për provimin e maturës merret nga Komisioni në Qendra të Testimit dhe dorëzohet po te i njëjti Komision me procesverbal.
5. Administruesit dhe vëzhguesit mbajnë përgjegjësi ligjore, individuale sipas dispozitave ligjore në fuqi për ruajtjen e sekretit dhe sigurimin e testeve deri në momentin e dorëzimit të tyre në Komisionin Qendrës së Testimit.
6. Detyrat dhe përgjegjësit tjera të Administruesve dhe Vëzhguesve do të përcaktohen me akt nënligjor.

**Neni 13**  
**Komisionet e shkollave për provimin përfundimtar**

1. Komisionet e shkollave përbëhen nga tre (3) anëtarë.
2. Kryetar i Komisionit është drejtori i shkollës ose personi i autorizuar nga ai, ndërsa anëtarët e tjerë zgjidhen nga këshilli i shkollës.
3. Detyrat dhe obligimet e komisionit të shkollave janë :
  - 3.1. publikimi në mjediset e shkollës i të gjitha dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për zhvillimin e provimit përfundimtar;
  - 3.2. pajisja e kandidatëve me formularët e aplikimit për provimin përfundimtar dhe pranimi i të njëjtit të plotësuar;
  - 3.3. rregullimi i ambienteve të mbajtjes së provimit përfundimtar;
  - 3.4. mbanë procesverbal për punën e komisionit dhe rezultatet e provimit përfundimtar, t'i bart në librin amë të nxënësit.
4. Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga organet mbikëqyrëse.
5. Për punën e vet komisioni mban përgjegjësi.

**Neni 14**  
**Këshilli i provimeve të shkollës për provimin përfundimtar**

1. Provimin përfundimtar organizohet nga:
  - 1.1. këshilli i provimeve të shkollës; dhe
  - 1.2. komisioni vlerësues;
2. Këshilli i provimeve të shkollës përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe atë:
  - 2.1. drejtori i shkollës, në mungesë të drejtorit zëvendësdrejtori ose personi i autorizuar nga drejtori;
  - 2.2. administratori/ sekretari i shkollës; dhe
  - 2.3. kryetarët e komisioneve vlerësuese.



**Neni 15**  
**Komisioni vlerësues i provimit përfundimtar**

1. Komisionet vlerësuese i emëron drejtori i shkollës në mbështetje të konsultimeve paraprake të aktiveve profesionale.
2. Komisionin vlerësues e përbëjnë tre (3) anëtarë:
  - 2.1. kryetari i aktivitetit të lëndës përkatëse;
  - 2.2. pyetësi; dhe
  - 2.3. anëtari i përhershëm i komisionit /kujdestari i klasës.
3. Anëtarët rezervë të komisioneve vlerësuese i cakton drejtori.

**Neni 16**  
**Afati i organizimit të provimeve**

1. Provimi përfundimtar organizohet në fund të vitit mësimor para provimit të maturës, ndërsa kandidati i cili nuk ka kryer provimin përfundimtar nuk i lejohet të hyjë në provimin e maturës.
2. Provimi i maturës organizohet në dy afate të rregullta: në afatin e qershorit dhe gushtit, për afate të jashtëzakonshme vendos ministri.
3. Data e mbajtjes së provimit të maturës, caktohet nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ajo bëhet publike.
4. Kandidati, i cili nuk i kryen provimet e maturës, sipas kriterit të kalueshmërisë në afatin e caktuar, apo nuk i nënshtrohet provimit të maturës për shkaqe të ndryshme, përsërit provimin e maturës.
5. Kandidati, i cili nuk arrin kriteret e kalueshmërisë të provimit të maturës në afatet e rregullta dhe atyre të caktuara me vendim të MASHT-it, i nënshtrohet provimit të maturës në vitin vijues shkollor.

**Neni 17**  
**Paraqitja e provimit përfundimtar dhe të maturës**

1. Kandidati është i detyruar që të paraqes hyrjen në provimin përfundimtar ose të maturës më së voni dhjetë (10) ditë para ditës së fillimit të provimeve të maturës.

2. Fletëparaqitja për provimin përfundimtar dhe të maturës plotësohet në formularin që merret në shkollë, i cili përmban të dhënat për kandidatin, numrin dhe datën e dëftesës mbi kryerjen e klasës së 12/13.

3. Bashkë me fletëparaqitjen kandidati paraqet edhe:

3.1. dëftesat për kryerjen e klasave të shkollës së mesme të lartë;

3.2. certifikatën nga libri amë i të lindurve; dhe

3.3. dëshminë për kryerjen e pagesës në bankë;

3.4. për hyrjen në provimin e maturës kandidatët që kanë kryer provimin përfundimtar duhet të paraqesin edhe dëshminë e kryerjes së provimit përfundimtar.

4. Kryetari i Komisionit të Shkollës dhe , pasi të ketë vërtetuar se kandidati i plotëson kushtet për provimin përfundimtar ose të maturës, në harmoni me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, i lejohet hyrja në provimin përfundimtar ose të maturës.

5. Vlera e pagesës për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore caktohet për çdo afat nga KQSHM.

## **Neni 18**

### **Përmbajtja e provimit të maturës**

1. Provimi i maturës përbëhet nga:

1.1. lëndët e përgjithshme të cilat janë: gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe matematikë;

1.2. lëndët zgjedhore të përcaktuara varësisht nga tipi i gjimnazit.

2. Kandidatet e shkollave profesionale, klasa XIII dhe nxënësit e shkollave artistike:

2.1. në provimin e përfundimtar hyjnë në pjesën teorike dhe praktike.

2.2. në provimin e maturës nga lëndët e përgjithshme të mësuara me plan programin mësimor.

3. Modeli i testit për vlerësimin e provimit të maturës, do të përgatitet nga Qendra e Vlerësimit.

**Neni 19**  
**Kriteret e provimit të maturës**

1. Kriteret e provimit të maturës i përcakton MASHT me akt nënligjor.
2. Çdo kandidat që i nënshtrohet provimit të maturës, pragu i kalueshmërisë është 50% nga rezultati i përgjithshëm i arritshmërisë së pikëve të provimit të maturës.
3. Kandidati, i cili e arrin kriterin e kalueshmërisë sipas paragrafit 2 të këtij neni, shpallet i diplomuar i shkollës së mesme të lartë dhe arrin kushtin e përgjithshëm për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm.
4. Kandidati, i cili nuk e arrin rezultatin e kalueshmërisë sipas paragrafit 2 të këtij neni shpallet përsëritës i provimit të maturës.

**Neni 20**  
**Obligimet e Arsimit të Lartë**

1. Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë janë të obliguara që t'i pranojnë rezultatet e arritura të kandidatëve gjatë viteve të shkollimit të mesëm (vlerësimi i brendshëm) dhe rezultatet e provimit të maturës shtetërore (vlerësimi i jashtëm).
2. Pranimi i studentëve do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura:
  - 2.1. 20% gjatë shkollimit të mesëm dhe të lartë;
  - 2.2. 50% në provimin e maturës shtetërore;
  - 2.3. 30% në vlerësimin e brendshëm të njësive akademike..
3. Afati kur provimi i maturës do të jetë i vetmi kusht për pranimin e studentëve në Institucionet e Arsimit të Lartë, është përcaktuar në dispozitat kalimtare të këtij ligji.

**Neni 21**  
**Vendi i mbajtjes së provimit**

1. Provimi përfundimtar mbahet në lokalet e shkollës ose në lokale tjera ku e cakton Komisioni i shkollës.
2. Provimi i maturës, mbahet në lokalet e shkollës ose në lokale tjera për të cilat vendos Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës.
3. Lokalet ku mbahet provimi përfundimtar dhe i maturës duhet t'i plotësojë këto kritere:

- 3.1. të kenë hapësirë të mjaftueshme për mbajtjen e provimit pa pengesë,
- 3.2. të kenë ndriçim dhe ajrosje të mjaftueshme
- 3.3. të mos ketë materiale, tabela ose materiale tjera që kanë të bëjnë me provimin,
- 3.4. të jenë të mbikëqyrura dhe siguruar që kandidatët t'i nënshtrohen provimit të pa penguar nga të tjerët.

## **Neni 22**

### **Vërtetimi i identitetit të kandidatëve**

Vërtetimi i identitetit të kandidatëve gjatë hyrjes në provimin përfundimtar ose të maturës bëhet përmes dokumenteve zyrtare të identifikimit.

## **Neni 23**

### **Kohëzgjatja e provimit**

Provimi i maturës do të zgjatë njëqindetëdhjetë (180) minuta.

## **Neni 24**

### **Ndalimi i vazhdimit të provimit në shkollën tjetër**

Kandidati, i cili ka filluar provimin përfundimtar në një shkollë nuk mund ta vazhdojë provimin në shkollën tjetër.

## **Neni 25**

### **Publikimi i rezultateve të provimit**

Qendra e Vlerësimit është e obliguar që menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve të provimit të maturës ato t'ia propozoj KQSHM-së për miratim dhe publikim.

## **Neni 26**

### **E drejta në ankesë**

1. Të drejtë ankesë kanë të gjithë kandidatët të cilët nuk janë të kënaqur me procesin e verifikimit dhe vlerësimit të tyre.
2. Afati për ankesë është tri (3) ditë pas publikimit të rezultatit.

**Neni 27**  
**Subjekti tek i cili dorëzohet ankesa**

1. Kandidati ka të drejtë të parashtrojë ankesë :
  - 1.1. në shkallë të parë:
    - 1.1.1. në Komisionin e vlerësimit të shkollës për provimin përfundimtar; dhe
    - 1.1.2. në KQSHM për provimin e maturës;
  - 1.2. në shkallë të dytë në Komisionin për Parashtrësia dhe Ankesa pranë MASHT-it.

**Neni 28**  
**Afati kohor për parashtrimin e ankesës**

Afati për parashtrimin e ankesës në organin e shkallës së parë është (tri)3 ditë pas publikimit të rezultateve, ndërsa në organin e shkallës së dytë bëhet brenda (tetë) 8 ditësh nga dita kur kandidati ka marrë përgjigjen në ankesë.

**Neni 29**  
**Afati për marrjen e vendimit**

1. Afati për marrjen e vendimit në përgjigje në ankesë:
  - 1.1. nga Komisioni vlerësues është shtatë (7) ditë;
  - 1.2. ndërsa afati për marrjen e vendimit nga MASHT-i, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur kandidati ka parashtruar ankesën.

**Neni 30**  
**Ruajtja dhe arkivimi**

1. Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të provimit përfundimtar dhe të maturës do të bëhet në bazë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
2. Procesverbalin nga mbledhja e Komisionit Qendror dhe Komisionit të shkollës e nënshkruan kryetari, sekretari dhe anëtarët.
3. Libri i procesverbaleve nga provimi, është me vlerë të gjatë dhe mbahet në fletore të fortë.
4. Notat përfundimtare nga lëndët e provimit përfundimtar barten nga procesverbali në Librin amë.

### **Neni 31**

#### **Certifikata, Diploma**

1. Kandidatëve që kryejnë provimin përfundimtar u lëshohet Certifikata.
2. Kandidatëve të cilët e kanë dhënë provimin e maturës u jepet diploma për kryerjen e shkollës së mesme të lartë.
3. Forma dhe përmbajtja e Certifikatës së provimit përfundimtar dhe Diplomës së provimit të maturës rregullohet me vendim të veçantë të MASHT.

### **Neni 32**

#### **Financimi**

1. Të gjitha të hyrat që realizohen nga ky ligj janë para publike dhe derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.
2. Pagesa e participimit të kandidatëve do të bëhet në bankë.
3. Ministri i MASHT-it dhe MEF lidhin Memorandum Mirëkuptimi për trajtimin e të hyrave vetanake.

### **Neni 33**

#### **Sanksionet**

1. Kryetari, anëtari, administruesi ose vëzhguesi i testit të maturës i cili zbulon ndonjë sekret të testit që konsiderohet si shkelje e lehtë, dënohet për kundërvajtje në shumë prej pesëqind (500) deri në njëmijë (1000) € duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe rënduese si dhe me masa disiplinore.
2. Kryetari, anëtari, administruesi ose vëzhguesi i testit të maturës, i cili zbulon ndonjë sekret të testit që konsiderohet si shkelje e rëndë e testit të maturës dënohet me dënim në të holla prej dymijë (2000) deri në pesëmijë (5000) € si dhe me masa disiplinore dhe penale të parapara në nenin 169 të Kodit Penal të Kosovës si vepër penale e zbulimit të paautorizuar të informacionit të besueshëm.

## **KREU III**

### **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

#### **Neni 34**

### **Dispozitat kalimtare dhe të fundit**

1. Rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore merren për bazë për pranim në Institucionet e Arsimit të Lartë gjatë vitit akademik 2011/2012.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë se vlejtori dispozitat që kanë rregulluar këtë fushë.

#### **Neni 35**

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L-018**  
**6 nëntor 2008**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**